



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr.289/1 Prot Tiranë, më 25.09.2020

Nr.2581/1 Prot Tiranë, më 25.09.2020



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

DHE

UNIVERSITETIT TË TIRANËS



Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Universiteti i Tiranës, të cilat në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

Duke patur parasysh objektin e veprimtarisë institucionale të tyre;

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare me qëllim dhënien e mundësisë së studimit pranë Universitetit të Tiranës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare;

Me dëshirën për të nxitur forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare, për të ndihmuar në ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe traditave kombëtare me mundësimin për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj Marrëveshje për të përmbushur angazhimet në kuadër të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e diasporës për vitin akademik 2020-2021”,

Bien dakord si vijon:

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është zbatimi i Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e diasporës për vitin akademik 2020-2021”.

Neni 2 **Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit reciprok. Palët kontribuojnë në zbatimin e kësaj marrëveshje në përputhje me mundësitë dhe kompetencat që kanë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Palët njohin interesin e përbashkët në forcimin, përmirësimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit me diasporën shqiptare.



Neni 3 **Përgjegjësitë e palëve**

1. Universiteti i Tiranës merr përsipër të ofrojë 9 (nëntë) kuota pranimi për studentët e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020 – 2021, sipas përzgjedhjes paraprake që bën Komisioni i Dhënies së Bursave, në përputhje me Vendimin Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021”.

2. Agjencia Kombëtare e Diasporës merr përsipër të financojë bursat e 9 (nëntë) studentëve të huaj me origjinë shqiptare nga komunitetet shqiptare të Ukrainës, Italisë, Kroacisë dhe Bullgarisë për vitin akademik 2020 – 2021, në përputhje me kërkesat dhe kushtet financiare të Universitetit të Tiranës si dhe të lehtësojë procedurat për regjistrimin e tyre.

Neni 4 **Përpunimi i të dhënave personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshjeje.

Neni 5 **Format e bashkëpunimit**

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshjeje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6 **Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

Neni 7 **Afati**

Kjo Marrëveshjeje lidhet me afat të pacaktuar.



Neni 8 Tërheqja nga marrëveshja

1. Palët rezervojnë të drejtën për të ndryshuar pjesërisht apo në tërësi marrëveshjen dhe për t'u tërhequr nga ajo.
2. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas një (1) muaji nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për t'u tërhequr nga lidhja e kësaj marrëveshje.
3. Për detyrimet e krijuara përpara përfundimit të kësaj marrëveshje, marrëveshja do të mbetet në fuqi për gjithë kohëzgjatjen e ciklit të studimeve, objekt i kësaj marrëveshje.

Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.

Neni 11 Gjuha e marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) kopje për Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe 2 (dy) kopje për Universitetin e Tiranës.

Nënshkruar në Tiranë, në _____.____.2020.

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

UNIVERSITETI I TIRANËS

DREJTOR EKZEKUTIV

REKTOR

SONILA HYSI

PROF. DR. ARTAN HOXHA